



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLICA OF KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Niveli i Origjinalit Orig Unit	5P-02
Niveli i Faqeve Pages	105
Nr. i Prot. Prot. No.	4128-2/23
Data Date	22.02.24
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	20.12.2023
REFERENC-Ë:	23/4128/ MMPHI
PËR/ZA/TO:	"X Fort" Sh.p.k.- Doganaj, Kaçanik
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 23/4218/340/DMMU dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për kompaninë "X Fort" Sh.p.k. - Doganaj, Kaçanik - për fabrikën e prodhimit të llaqeve, ngjitësve, fasadave dhe ngjyrave, me numër të parcelave P- 70917026-00345-1 , P- 70917026-00459-4 në Z.K Doganaj – Komuna Kaçanik.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 6

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrotjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

"X Fort" Sh.p.k. - Doganaj, Kaçanik pajiset me Pëlqim Mjedisor për veprimtarinë: për fabrikën e prodhimit të llaqeve, ngjitësve, fasadave dhe ngjyrave, me numër të parcelave P- 70917026-00345-1, P- 70917026-00459-4 në Z.K Doganaj – Komuna Kaçanik, nën kushtet si vijon:

- Gjatë realizimit të procesit teknologjik, duhet të merren të gjitha masat për evitimin e ndotjes së mjedisit nga mbeturinat e ngurta, evitimin nga derdhja e vajrave dhe karburanteve nga makinat.
- Të vendoset sistemi për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave industriale dhe atyre të krijuara nga reshjet atmosferike në tërë sipërfaqet operationale (puset sedimentuese dhe seperatori), para shkarkimit të tyre,.

Faqe 2 nga 6

- Të vendosen stabilimentet depluhuese (ventilatorët me ciklona dhe filtra).
- Të bëhet monitorimi i përhershëm i filtrave të pluhurit, të dëmtuarit të ndërrohen.
- Të bëhet mbyllja hermetike e gypave dhe kanaleve për përcjelljen (transportin) e fasadës dhe llaqeve, të izolojnë të gjitha pikat gjeneruese të pluhurit.
- Të vendosen pajimet adekuate për deponimin e mbeturinave të ngurta dhe të lëngta.
- Të bëhet nivelizimi, gjelbërimi i terenit dhe rregullimi i rrethojës së terenit afër fabrikës.
- Të bëhet plani për masat rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit, gjatë zbatimit të projektit si dhe pas përfundimit të tij.
- Në kohra të nxehta të bëhet stërpikja e sipërfaqeve operationale kohë pas kohe, me ujë, me qëllim të zvogëlimit të pluhurit.
- Aplikuesi përpos kushteve të lartë cekura duhet t'i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Kompania "X Fort" Sh.p.k. - Doganaj Kaçanik - - për fabrikën për prodhimin e llaqeve, ngjitësve, fasadave dhe ngjyrave në parcelat me Nr. P-70917026-00345-1 dhe P- 70917026-00459-4 në Doganaj, Kaçanik, duhet të i plotësoi kushtet e parapara në Raportin e VNM-së, për të plotësuar kushtet mjedisore të parapara me Legjislacionin në fuqi.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lart cekura, pëlqimi do të anulohet (revokohet).

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumentacionin përcjellës të dorëzuar, nga "X Fort" Sh.p.k. - Doganaj Kaçanik - për fabrikën për prodhimin e llaqeve, ngjitësve, fasadave dhe ngjyrave në parcelat me Nr. P-70917026-00345-1 dhe P- 70917026-00459-4 në Doganaj, Kaçanik, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me rekomandim të Komisionit për VNM, nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqim Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181.

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 të Ligjit për VNM 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimi të njejtë.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 23/4128/1 - ZSP/ /23 datë: 20.12.2023

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Komunës së Kaçanikut
6. Divizionit për komunikim me publikun
7. Arkivit të MMPHI

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të
MMPHI

Faqe 4 nga 6

2. SHTOJÇE : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRI E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRI E ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Niveli i Org. Jedinica Org. Unit	Proj. Prot. Proj. No.
Str. i Fajev Str. i Fajev	Data Date
Str. i Stranica Str. i Stranica	Str. i Stranica Str. i Stranica
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave/Departament za Zaštitu Sredine i Voda
Department of Environment Protection and Waters

REFERENCE:	23/4128/340/DMMU				
PËR/ZA/TO:	Izedi Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së				
NGA/OD/FROM:	Abdullah Pirçe, Kryesues i Komisionit për VNM				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje kërkesës të Kompanisë "X Fort" Sh.p.k.- Doganaj Kaçanik - për fabrikën për prodhimin e llaqeve, ngjithësve, fasadave dhe ngjyrave në Doganaj, Kaçanik.				
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	1517	Lokacioni: Kucni: Extension:	Ish Pallati i Mediave, Rilindja Prishtinë.	Data: Datum: Date:	20.12.2023
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					☐
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					☒
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					☒
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					☐
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS					☐
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					☒
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					☒
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					☒
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					☐
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

Kompania "X Fort" Sh.p.k.- Doganaj Kaçanik – për fabrikën për prodhimin e llaqeve, ngjitësve, fasadave dhe ngjyrave në Doganaj, Kaçanik, me 20.07.2023 ka aplikuar për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor me nr. prot. 23/4128/340/DMMU.

Kërkesës për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Raportin e VNM-së të plotësuar në katër kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD), të nëshkruar dhe të vulosur nga bartësi i projektit;
- Pëlqimi i Kuvendit të Komunës;
- Faturën e pagesës së shërbimit për pëlqim mjedisor;
- Çertifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Kopjën e Planit;
- Çertifikatën e pronësisë;
- Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit.



Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Raportit të VNM-së, dokumentacionit përcjellës, të kompanisë "X Fort" Sh.p.k.- Doganaj Kaçanik - për fabrikën për prodhimin e llaqeve, ngjitësve, fasadave dhe ngjyrave në parcelat me Nr. P-70917026-00345-1 dhe P- 70917026-00459-4 në Doganaj, Kaçanik është konstatuar se mungon:

- Dëshmia për vlerën financiare investuese;
- Plani i situacionit i nënshkruar dhe i vulosur nga Gjeodeti i licencuar;
- Nënshkrimi i hartuesit dhe investitorit në Raportin e VNM-së.

Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, neni 16, me datën 01.11.2023 është mbajtur debati publik. Bazuar në procesverbalin e dërguar nga Kompania në debat përveq përfaqësuesve të Kompanisë dhe hartuesve të Raportit të VNM-së, si dhe përfaqësuesi i MMPHI-së përmes platformës ZOOM, nuk kishte pjesëmarrës tjerë.

Bazuar në nenin 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, Komisioni për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis pas shqyrtimit të të gjitha rrethanave lidhur me

këtë projekt rekomandon Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së që ti **Lëshohet Pëlqimi Mjedisor** Kompanisë "X Fort" Sh.p.k. - Doganaj Kaçanik - për fabrikën për prodhimin e llaqeve, ngjitësve, fasadave dhe ngjyrave në parcelat me Nr. P-70917026-00345-1 dhe P-70917026-00459-4 në Doganaj, Kaçanik, nën kushtet si vijon:

- Gjatë realizimit të procesit teknologjik, duhet të merren të gjitha masat për evitimin e ndotjes së mjedisit nga mbeturinat e ngurta, evitimin nga derdhja e vajrave dhe karburanteve nga makinat.
- Të vendoset sistemi për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave industriale dhe atyre të krijuara nga reshjet atmosferike në tërë sipërfaqet operationale (puset sedimentuese dhe seperatori), para shkarkimit të tyre.
- Të vendosen stabilimentet depluhuese (ventilatorët me ciklona dhe filtra).
- Të bëhet monitorimi i përhershëm i filtrave të pluhurit, të dëmtuarit të ndërrohen.
- Të bëhet mbyllja hermetike e gypave dhe kanaleve për përcjelljen (transportin) e fasadës dhe llaqeve, të izolojnë të gjitha pikat gjeneruese të pluhurit.
- Të vendosen pajimet adekuate për deponimin e mbeturinave të ngurta dhe të lëngta.
- Të bëhet nivelizimi, gjelbërimi i terenit dhe rregullimi i rrethojës së terenit afër fabrikës.
- Të bëhet plani për masat rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit, gjatë zbatimit të projektit si dhe pas përfundimit të tij.
- Në kohra të nxehta të bëhet stërpikja e sipërfaqeve operationale kohë pas kohe, me ujë, me qëllim të zvogëlimit të pluhurit.
- Aplikuesi përpos kushteve të lartë cekura duhet t'i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.



Kompania "X Fort" Sh.p.k. - Doganaj Kaçanik - për fabrikën për prodhimin e llaqeve, ngjitësve, fasadave dhe ngjyrave në parcelat me Nr. P-70917026-00345-1 dhe P-70917026-00459-4 në Doganaj, Kaçanik, duhet të i plotësoi kushtet e parapara në Raportin e VNM-së, për të plotësuar kushtet mjedisore të parapara me Legjislacionin në fuqi.

Pëlqimi Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214.

Bashkëgjitur me mendim profesional e gjeni draft Vendimin

Komisioni:

Abdullah Pirçe, kryesues
Malsore Jonuzi, anëtare - pushim
Rizah Muqolli, anëtar
Sylejman Latifi, antar
Musli Kozhani, anëtar

